



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Mbledhja nr. 51
Prishtinë, më 24.1.2019, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Driton Çaushti, Abdyl Salihu dhe Albulena Balaj-Halimaj.

Munguan: Arbërie Nagavci, Fidan Rekalju, Mufera Shinik, Verica Çeraniç dhe Nezir Çoçaj.

Të ftuar ishin rektorët: Marjan Dema, Universiteti "Hasan Prishtina"- Prishtinë, Bajram Kosumi, Universiteti "Kadri Zeka"- Gjilan, Fadil Millaku, Universiteti "Haxhi Zeka"- Pejë, Ismet Temaj, Universiteti "Ukshin Hoti"- Prizren, Shaban Buza, Universiteti "Fehmi Agani"- Gjakovë, Alush Musaj, Universiteti "Isa Boletini"- Mitrovicë dhe Agron Bajraktari, Universiteti i Shkencave të Aplikuara- Ferizaj.

Përfaqësues tjerë: përfaqësues të KDI-së dhe mediave.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi, Ismajl Kurteshi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Diskutim në lidhje me kërkesën e Rektorëve të Universiteteve Publike rreth programeve të paakredituara;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Diskutim në lidhje me kërkesën e Rektorëve të Universiteteve Publike rreth programeve të pa akredituara

Ismail Kurteshi, në diskutimin e tij tha se ky takim është më interes për t'u informuar lidhur shqetësimet e ngritura për mosrespektim të kriterëve dhe procedurave nga ana e Agjencisë së Akreditimit, rreth mos akreditimit të një numri të caktuar të programeve në universitetet publike.

Marjan Dema, rektor i Universitetit të Prishtinës, tha se më 18.1.2019, në orën 21:30, Zyra për Zhvillim Akademik, ka pranuar përmes e-mailit një njoftim nga zyra e AKA-së, për vendimet e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, të dala nga mbledhjet e mbajtura më 15 dhe 16.1.2019.

Sipas njoftimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë, pas analizimit të gjendjes dhe bazuar në përgjegjësitë e kompetencat të cilat dalin nga udhëzimi administrativ 15/2018 për akreditim, është nxjerr vendim që:

1. Të aprovojë/refuzojë aplikacionet për akreditim institucional dhe të programeve të studimit.
2. Të aprovojë apo të tërheqë akreditimin për programin e studimeve, të cilat nuk i përmbushin kriteret e parapara sipas normativit ligjor.

Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", i janë refuzuar 24 programe të studimit, 11 prej tyre janë refuzuar për vazhdimin e procedurave për akreditim/riakreditim, ndërkaq janë tërhequr 13 programe ekzistuese të akredituara, disa nga të cilat të akredituara deri në vitin 2023, ndërsa shqyrtimi i programeve të Fakultetit të Arteve, nuk është bërë nga KSHC-ja.

Për disa programe të refuzuara, janë dhënë arsyet nga KSHC-ja, si: mungesa e dokumentacionit të bartësve të programeve, apo probleme teknike, është kërkuar të konstatojmë se Zyra për Zhvillim Akademik në UP, ka dhënë sqarime në raportin e dërguar në AKA-ja. Për një numër tjetër të programeve KSHC-ja nuk kanë dhënë arsyetime.

Udhëzimi administrativ, (MASHT) nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, ka hyrë në fuqi më 28.9.2018, dhe nga IAL-të është kërkuar që të gjitha afatet kohore të respektohen sipas këtij UA, ku njëkohësisht në sistem është futur edhe sistemi elektronik për deklarimin e stafit akademik E-Akreditimi.

Bazuar në Udhëzimin Administrativ (MASHT) nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, mund të konstatohet se:

- KSHC-ja ka sjellë vendim për tërheqje të programeve të akredituara pa pasur raport të rekomandimit nga vlerësuesit e jashtëm,
- Nuk ka konstatime nga AKA-ja se ka pasur shkelje të kushteve të dhëna me rastin e akreditimit, ose dorëzuar informata dhe dokumentacione të rreme, në bazë të së cilës AKA-ja ka mundur të bëjë revokimin/tërheqjen e Akreditimit. Nuk kemi pasur monitorim të vlerësuesve ndërkombëtarë për programet ekzistuese, për të konstatuar se rekomandimet e ekspertëve vlerësues të jashtëm nuk janë implementuar sipas afateve kohore, të përcaktuara në raportin e vlerësimit dhe/apo gjendja faktike në institucion është dëmtuar rëndë në aspektin e cilësisë, dhe se programet e akredituara nuk kanë rënë ndesh me Nenin 21 të UA-së në fjalë, dhe të ndodhë revokimi/tërheqja e akreditimit,

- Refuzimi i aplikacioneve për akreditim/riakreditim të disa programeve të studimit të Universitetit të Prishtinës, është bërë në kundërshtim me Nenin 10 paragrafi 1.3 dhe 1.3.2., Nenit 25, Nenit 26 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim të Institucioneve të Arsimit të lartë në Republikën e Kosovës

- Vlerësimet për bartësit e programeve do të duhej të bëheshin nga ekspertët vlerësues ndërkombëtarë të fushës së njëjtë të studimit, të cilët bëjnë vlerësimin e programit gjatë programit të akreditimit nga AKA-ja

- E-Akreditimi ka pasur shumë probleme gjatë funksionimit, ku si pasojë ka mësimdhënës që nuk kanë mundur të hapin llogari në E-Akreditimi dhe kanë mbetur pa u regjistruar në sistem për shkak të mbylljes së sistemit me datën 31.10.2018, çështje të cilat janë raportuar në AKA. AKA-ja ka dhënë mundësi shtesë vetëm për ata që kanë pasur llogari dhe kanë hasur në pengesa. Përveç afatit të deklarimit që është caktuar në UA-ja si afat i fundit 31 tetori, ky afat është caktuar dhe për dorëzimin e aplikacioneve për programet e studimit.

Fadil Millaku, rektor i Universitetit të Pejës, tha se e kemi pranuar njoftimin nga Agjencia e Akreditimit dhe më pas është mbajtur Konferenca e rektorëve dhe është reaguar ndaj vendimit të KSHC-së, duke e konsideruar si një vendim i padrejtë. Programet që janë mbyllur nga KSHC-ja konsideron se janë të politizuara, pa bazë ligjore dhe konform qëndrimeve të Ministrisë së Arsimit, e cila prej fillimit ka qenë për mbylljen e Universiteteve të reja e po ashtu janë bërë gabime me rastin e vlerësimit të fushave të studimit të stafit akademik. Ky vendim i KSHC-së ka prekur ma shumë se 40% të programeve në universitetet publike, në veçanti në universitetet publike të reja, dhe mund të themi se janë prekur programet, ku ka më së shumti studentë.

Bajram Kosumi, rektor i Universitetit të Gjilanit, tha se me vendimin që e ka marrë Konferenca e rektorëve, tek fjalia që thuhet që AKA-ja, ka treguar papërgjegjësi. Udhëzimi numër 15/2018, i vitit 2018, i nënshkruar – neni 21 thotë: AKA-ja mund të rishqyrtojë akreditimin e dhënë në çfarëdo kohe dhe apo më pas ta tërheqë vendimin e saj për akreditim, nëse kushtet e dhëna me rastin e akreditimit janë shkelur, është e qartë. Programet të cilat janë mbyllur në Universitetin e Gjilanit, 90% e tyre janë programe të akredituara në vitin 2016-2017. Procesi i akreditimit është proces kompleks dhe nuk bëhet për një ditë apo dy, ai merr kohë dhe i nënshtrohet një procesi të vlerësimit të ekspertëve të jashtëm dhe e njëjta procedurë duhet të ndiqet me rastin e tërheqjes së akreditimit.

Gjatë vitit 2018, Ministria e Arsimit dhe KSHC-ja ka vendosur dy kushte shtesë, dy kushte mbrapa akreditimit: kushti i pare është, që në vend të profesorëve për një program, duhet t'i kemi 4, një profesor për 60 kredit ECTS. Fakulteti i Edukimit është akredituar me 3 profesorë, i ka kaluar të gjitha këto procedura. KSHC-ja vitin e kaluar na ka dërguar një letër, duke kërkuar të rritet numri i profesorëve në 4. Kërkesa e KSHC-së, për rritjen e numrit të profesorëve për një program studimor është antiligjor. Ata mund ta shtojnë këtë standard në rast të riakreditimit të programeve të reja, por jo ndaj atyre që janë akredituar.

Agron Bajraktari, rektor i Universitetit të Ferizajt, në diskutimin e tij tha se vendimi i KSHC-së është arbitrar dhe i kundërligjshëm, dhe mund ta them që mbyllja e universiteteve nga Ministria e Arsimit është synim kryesor nga ardhja e këtij ministri. U tha që janë mbyll 40% të programeve të universiteteve të reja publike, në të cilat programe studiojnë rreth 70% e studentëve. Si universitet i ri, ne jemi proces të zhvillimit dhe kompletimit të stafit dhe infrastrukturë dhe mbyllja e programeve është kundërligjore dhe arbitrare.

Shaban Buza, rektori i Universitetit të Gjakovës, tha se në kohën kur nevojitet një profilizim i institucioneve të arsimit të lartë, vjen një vendim i papritur i KSHC-së, ku nga 14 programe të akredituara në edukim në Kosovë, vetëm njëjës i mbetet akreditimi, që i bie se 13 programeve u është tërhequr akreditimi, andaj edhe kjo është arsyeja pse ne kemi reaguar. Në Universitetin e Gjakovës ka mbetur vetëm programi “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe”. Universiteti i Gjakovës e ka edukimin, dhe e ka infermierinë dhe maminë, pas UP-së, e kemi të vetmit maminë e akredituar, as UP-ja nuk e ka të akredituar. Vërejtjet tona ndaj KSHC-së kanë të bëjnë me kriteret e vlerësimit të stafit akademik, për sa i përket fushave të programeve, ku dihet se për programet e studimit në edukim, nuk ka kuadro të veçantë për këtë fushë, pasi që fusha e edukimit është multidisiplinare, do të duhej të merreshin parasysh edhe fushat e përafërta.

Ismet Dema, ud. rektor i Universitetit të Prizrenit, tha se shqetësimet janë të njëjta dhe më këtë rast Universiteti i Prizrenit, sikur të tjerët është atakuar me tërheqjen e akreditimit të disa programeve.

Alush Musaj, rektori i Universitetit të Mitrovicës, tha se nga njoftimi i KSHC-së jemi befasuar për të keq, në Universitetin e Mitrovicës u është tërhequr akreditimi programeve shumëvjeçare nga fusha e inxhinierisë, të cilat janë të vetmet në Kosovë. Problemi qëndron tek Udhëzimi Administrativ, i cili nuk ka paraparë afat kohor që institucionet e arsimit të lartë të përgatiten për zbatimin e tij.

Albulena Balaj-Halimaj, tha se lidhur me deklaratimet e rektorëve, se ministri ka thënë se do të mbyllet universitetet nuk është e vërtetë, ngase një propozim për riorganizim të universiteteve në dy kampuse dhe degë tjera, ka ardhur me propozimin e një grupi punues prej ekspertëve që kanë bërë një analizë të qëndrueshmërisë së universiteteve për një arsim më të mirë në Kosovë. Prandaj, asnjëherë nuk ka thënë ministri që do të mbyllet universitetet.

Sa i përket paralajmërimit për greva, mendoj që duhet të ndiqen rrugët ligjore. AKA-ja është agjenci e pavarur, e cila nuk menaxhohet nga ministri. Anëtarët e KSHC-së, janë zgjedhur me konkurs publik, ku secili profesorë që i ka plotësuar kushtet, ka pasur të drejtë aplikimi dhe përzgjedhja e tyre është bërë nga një komision i caktuar, në të cilin kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të shoqërisë civile, dhe pastaj është bërë emërimi i tyre në Kuvendin e Kosovës.

Teuta Haxhiu, tha se kam insistuar që në këtë takim të jetë të pranishëm edhe anëtarët e KSHC-së, të kemi ballafaqimin e dy palëve, por një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Sa i përket themelimit të universiteteve të reja, mendoj se ato duhet të funksionojnë duke u angazhuar për ngritjen e cilësinë së programeve që ofrojnë. Njoftimi i KSHC-së për mbyllje të programeve më së tepërmi i prek studentët dhe prindërit e tyre, të cilët nuk e kanë mundësinë e shkollimit të fëmijëve të tyre në qendra të ndryshme dhe institucione private. Kërkoj nga rektorët që të shfrytëzojnë të drejtën e ankesës në shkallë të dytë, nëse mendojnë se ky vendim është i padrejtë. Shqetësim mbetet çështja e tërheqjes së akreditimit për disa programe, të cilat kanë pasur akreditim edhe për dy apo tre vite, sikurse edhe angazhimi i stafit akademik, në më shumë se 4-5 vende, e që është e pamundur të arrihet.

Disa nga rektorët ngritën çështjen e kriterëve shtesë me udhëzimin e ri administrativ dhe kërkoj sqarim nga rektorët, se cilat janë kriteret shtesë dhe specifikat sipas këtij udhëzimi, meqë kam marr pjesë në hartimin e këtij udhëzimi. Ajo që dëgjuam nga rektorët, janë diku 40% të programeve të mbyllura që kanë numrin më të madh të studentëve, dhe kjo është shqetësuese

duke pasur parasysh se institucionet private të arsimit të lartë, janë biznese fitimprurëse dhe dyshoj se interesi personal po del para të gjithave, prandaj i kisha lutur rektorët që këtë ta kenë si parësore.

Valentina Bunjaku-Rexhepi, tha se është për keqardhje ajo që dëgjuam nga rektorët dhe unë nuk dua të besoj që ka pasur diçka tendencioze gjatë nxjerrjes së vendimit të KSHC-së. Vendimet e KSHC-së për tërheqje të akreditimit për programet e caktuara dëmtojnë më se shumti studentët. Më tej, ajo tha se nuk mund të vihet në përfundim, se ku qëndron e drejta dhe gabimi pa i dëgjuar edhe përfaqësuesit e KSHC-së. Dihet që këto universitete janë hapur politikisht, por nuk duhet lejuar që të njëjtat të mbyllen politikisht, ngase universitetet nuk mbyllen ndryshe, përveçse duke ua mbyllur programet. Sipas saj, Universiteti i Gjilanit është i rëndësishëm sepse edhe studentët e Kosovës Lindore i ndjekin studimet dhe propozoi që rektorët të ndjekin rrugët ligjore dhe të shfrytëzojnë të drejtën e ankesës në shkallë të dytë në AKA.

Driton Çausi, theksoi se hapja e universiteteve ka qenë politike, ose të themi fushatë paraelektorale dhe asnjëra nga këto universitete nuk është hapur me ndonjë plan strategjik dhe sipas tij duhet të ketë një rivlerësim komplet të këtij procesi për profilizimin e këtyre universiteteve.

Sipas nenit 10, të Ligjit për Arsimin e Lartë, universiteti e njeh kriterin për një studim 5 vjeçar ose në 5 fusha dhe të këtë një të diplomuar me doktoratë në secilën nga këto fusha. Konsideroj se në bazë të këtij kriteri, themelimi i këtyre universiteteve është në kundërshtim me ligjin, si për nga emri ashtu dhe funksioni. Proporcioni student-profesor, në 6 universitete publike është jashtë çdo norme për të zhvilluar aktivitet shkencor. Hapja e këtyre universiteteve publike e ka përkeqësuar gjendjen në Universitetin e Prishtinës, kështu që në vend të ngritjes së cilësisë dhe përmirësimit të kushteve, ne e kemi bërë të kundërtën. FSHMN-ja përballlet me mungesë të kushteve minimale për punë e aktivitete shkencore, gjë që kanë paralajmëruar grevë për përmirësim të këtyre kushteve, e jo për ngritje të koeficienteve.

Sa i përket Fakultetit të Edukimit, nuk është e saktë që nuk ka fushë të ngushtë të studimit të edukimit, ku në vendet e BE-së ka programe në master dhe phd, në edukim dhe kjo nuk nënkupton që edukimi të përbehet me shume drejtime.

Ismail Kurteshi, tha se qëllimi i këtij takimi ka qenë ti dëgjojmë për se afërmi shqetësimet tuaja dhe po ju them se unë personalisht nuk pajtohem me moratoriumin e juaj dhe njëra nga arsyet që s'ju kemi ballafaquar me KSHC-në, ka qenë kërkesa e njërit prej rektorëve, andaj kërkoj nga ju që sa më parë të kontaktoni me KSHC-në dhe ti ballafaqoni argumentet. KSHC-ja është organ i pavarur dhe ne jemi të obliguar ta respektojmë pavarësinë e tyre, sikurse që edhe institucionet e pavarura vendimet e tyre duhet t'i bazojnë në ligji.

3. Të ndryshme.

Në këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 12:45.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Ismajl Kurteshi